R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 3207/1 prot. Tiranë, më 13.11.2026

Lënda: Bashkërendim mbi projektvendimin "Për masat përgatitore dhe shoqëruese për pjesëmarrjen e ardhshme të Republikës së Shqipërisë në Sistemin e Informacionit të Tregut të Brendshëm (IMI)"

MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit") ka administruar shkresën tuaj me nr. 7444/4 prot., datë 03.11.2026, me anë të së cilës përcillni për bashkërendim projektvendimin "Për masat përgatitore dhe shoqëruese për pjesëmarrjen e ardhshme të Republikës së Shqipërisë në Sistemin e Informacionit të Tregut të Brendshëm (IMI)", të ripunuar.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektvendimit konstatojmë se komentet dhe sugjerimet e Zyrës së Komisionerit, të përcjella nëpërmjet shkresës nr. 2889/1 prot., datë 19.10.2026, janë marrë në konsideratë dhe janë reflektuar në këtë projektakt.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit e vlerëson projektvendimin të hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi